

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Albert Zogaj, kryetar i kolegjit, Gëzim LLulluni dhe Nora Bllaca Dula, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Ndërmarrja Publike Banësore, Rr.”Bill Klinton” pn. Prishtinë, të cilën e përfaqëson e autorizuar V.K., juriste e diplomuar pranë të paditurës, kundër të paditurës O.J. “NN”-SH.M. Rr.”....” nr.13 Prishtinë, adresa e lokalit dhe adresa e banimit Rr.”....”, nr.13 Prishtinë, për shkak të borxhit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.189/06, i datës 18.09.2013, në seancën jo publike të mbajtur me datë 22.05.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës O.J. “NN”-SH.M. Rr. “...” nr.13 Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.189/06, i datës 18.09.2013, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.189/06, i datës 18.09.2013, me pikën I (një) të dispozitivit e ka miratuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses Ndërmarrja Publike Banësore në Prishtinë. Në pikën II (dy) të dispozitivit e ka detyruar të paditurën O.J.”NN”-SH.M., Rr. “....” nr.9/18, Prishtinë, që paditëses t’ia paguajë borxhin në emër të qirasë, për lokalin në Prishtinë Rr. “.....” nr.9/18 për periodën prej 30.04.2005 deri më 31.01.2006, shumën totale prej 5.102,00 Euro, me kamatë ligjore nga data e marrjes së aktgjykimit e deri në pagesën definitive si dhe t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës gjyqësore në shumë prej 40 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi i autorizuari i të paditurës në afat ligjor ka paraqitur ankesë duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuara të se drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën e të autorizuarit të të paditurës si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e atakuar ta ndryshojë ashtu që ta refuzojë kërkesëpadinë e paditëses, apo të njëjtin ta prishë dhe lënda t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të autorizuarit të të paditurës është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja Ndërmarrja Publike Banesore, Rr."Bill Klinton" pn. Prishtinë, me datë 24.02.2006, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi për pagesën e borxhit, kundër të paditurës O.J. "NN"-SH.M. Rr. "...." nr.13 Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditëses në emër të borxhit për qiranë e papaguar për lokalin afarist- në Prishtinë Rr. "...." nr.9/18 për periodën prej 30.04.2005 deri më 31.01.2006, t'i paguaj shumën totale prej 5.102,00 Euro, me kamatë ligjore nga data e marrjes së aktgjykimit e deri në pagesën definitive si dhe t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës gjyqësore, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor dhe pas administrimit të provave ka marrë aktgjykimin e atakuar C.nr.189/06, i datës 18.09.2013, me të cilin e ka miratuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses duke vendosur më decidivishtë si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata ka theksuar se palët ndërgjyqëse kanë lidhur kontratën mbi qiranë e lokalit afarist me nr.03-694/1, e datës 05.04.2005, sipas së cilës paditësja ia ka dhënë me qira lokalin afarist i cili gjendet në Prishtinë Rr."..." nr.9/18, për periudhën 01.02.2005 deri me 31.12.2005, me qira mujore prej 461,52 Euro. Ka shtuar se e paditura me kërkesën e datës 31.03.2006, e ka informuar paditësen për tërheqjen nga lokali, për shkak se për arsye objektive e paditura nuk është më në gjendje që edhe më tutje të vazhdojë me shfrytëzimin e lokalit afarist. Lartësinë e kërkesëpadisë e ka vërtetuar me kartelën e shfrytëzuesit prej së cilës ka vërtetuar se i padituri për periudhë kontestuese të lartcekur i ka ngelur borxh paditëses shumë prej 5.102,20 Euro.

Gjykata ka arsyetuar se në rastin konkret e paditura për shkak të mos pagesës së borxhit në emër të qirasë ka hyrë në raport detyrimor me paditësen, në të cilin raport paditësja e ka cilësinë e kreditorit ndërsa e paditura cilësinë e debitorit, andaj në kuptim të dispozitës së nenit 262 paragrafi 1 të LMD-së ka vendosur që ta miratojë si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore e ka mbështetur në dispozitat e nenit 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, për shkak se dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm dhe pa kontradikta brenda vetes dhe arsyetimit të

aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të mjaftueshme për përfundimin meritor të çështjes.

Nuk qëndrojnë pretendimet për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore lidhur me mënyrën e thirrjes së paditurit në shqyrtim, sepse nga shkresat e lëndës konstatohet se e paditura aktvendimin për përgjigje në padi së bashku me provat dhe shkresat e tjera të lëndës i ka refuzuar për pranim, po ashtu edhe ftesën për seancën e datës 18.09.2013. Refuzimi i shkresave dhe ftesës konsiderohet pranim i rregullt i të njëjtave në kuptim të nenit 112 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Në këtë kontekst pretendimet për mospranim të shkresave dhe ftesës për shqyrtim kryesor nuk janë të themelta.

Lidhur me pretendimet për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë jo të plotë dhe të gabuar, gjykata ankimore nuk i pranon si të themelta, për shkak se nga provat administruara në këtë çështje juridike kontestuese siç janë kontrata mbi qiranë e lokalit afarist e datës 05.04.2005, procesverbali mbi pranim dorëzimit të lokalit, nënshkruar nga komisioni i paditëses dhe deklarata mbi dorëheqjen nga lokali e datës 31.03.2006, e nënshkruar nga e paditura, si dhe kartela e shfrytëzuesit të lokalit, gjykata në mënyrë të pakontestueshme i ka provuar faktet thelbësore për themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë rast është provuar periudha e shfrytëzimit të lokalit me qira, lartësia e qirasë dhe përfundimisht lartësia e detyrimit.

Mbi këtë gjendje faktike të konstatuar sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë për themelësinë e kërkesëpadisë është i drejtë dhe i bazuar, pasi që me dispozitën e nenit 148 paragrafi 1 i Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore (LMD i vitit 1978) përcaktohet se :” *Kontrata krijon të drejta dhe detyrime për palët kontraktuese*”, ndërsa me dispozitën e nenit 262 paragrafi 1 parashihet se: ”*Kreditori në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij*”. Në kuptim të këtyre dispozitave rezulton se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka gjetur si të themeltë bazueshmërinë e kërkesëpadisë.

Për kamatën si kërkesë aksesore është zbatuar në mënyrë të drejtë e drejta materiale, neni 277 i LMD-së.

Lidhur me vendosjen për shpenzimet e procedurës Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosë për shpenzimet e procedurës duke e aplikuar dispozitën e 450 të LPK-së.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.4683/14, me datë 22.05.2018

Kryetari i kolegjit
Albert Zogaj, d.v